

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar (P5) **(zgjidhjet)**

Nr.

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test

Data: 14.01.2017

1. Dardha sh.a është një kompani e listuar në bursë me bazë në Europë. Ka pronësi të aksioneve në dy kompani tjera, Molla sh.a dhe Qershia sh.a. Pasqyrat e pozitës financiare janë paraqitur më poshtë për të tri kompanitë me 31 korrik 2016.

Pasqyrat e pozitës financiare me 31 korrik 2016

	Dardha sh.a	Molla sh.a	Qershia sh.a
	€ milion	€ milion	€ milion
Pasuritë jo-qarkulluese:			
Prona, fabrika dhe paisjet	500	145	100
Investimet	<u>300</u>	<u>48</u>	<u>5</u>
	800	193	105
Pasuritë qarkulluese:			
Stoqet	180	51	23
Të arkëtueshmet tregtare	64	24	13
Paraja & Banka	<u>24</u>	<u>13</u>	<u>8</u>
	<u>268</u>	<u>88</u>	<u>44</u>
Total pasuritë	1,068	281	149
<i>Ekuiteti:</i>			
Aksionet e ekuitetit prej €0.25 secila	250	100	40
Premia e aksioneve	200	80	20
Fitimet e mbajtura	<u>358</u>	<u>65</u>	<u>61</u>
	<u>808</u>	<u>245</u>	<u>121</u>
<i>Detyrimet afat-gjata:</i>			
6% notë krediti	100	---	---
<i>Detyrimet afat-shkurtëra:</i>			
Të pagueshmet tregtare	143	36	18
Dividenda e propozuar	17	---	10
Total detyrimet	<u>260</u>	<u>36</u>	<u>28</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,068	281	149

Informatat shitesë në vijim mund të jenë të rëndësishme:

- (i) Dardha bleu 300 milion aksione të zakonshme në Molla me 1 gusht 2014, kur fitimet e mbajtura të Mollës ishin €44 milion. Konsiderata për këto aksione ishte €220 milion. €120 milion prej kësaj shume ishte paguar në para në datën e blerjes, ndërsa pjesa e mbetur me një notë kreditit prej 6%. Investimi është regjistruar mirë sipas kostos në librat e Dardhës, i përfshirë nën titullin "Investimet". Interesi në notën e kreditit është paguar gjatë vitit të përfunduar me 31 korrik 2015, por nuk është bërë ndonjë regjistrim për të reflektuar interesin e pagueshëm në periudhën aktuale të kontabilitetit.
- (ii) Dardha bleu 40% të aksioneve të zakonshme të Qershia me 1 gusht 2015, kur saldo e fitimeve të mbajtura në librat e Qershia ishte €52 milion. Konsiderata përbëhej nga një pagesë e menjëhershme në para prej €50 milion. Drejtorët e Dardhës negociuan të drejtën e caktimit të 4 drejtorëve të bordit prej 12 peronave të Qershisë si rezultat i investimit të saj.

- (iii) Është politikë e grupit të vlerësoj Interesat Jo-kontrollues (IJK) sipas pjesës proporcionale të neto pasurive të identifikueshme në datën e blerjes.
- (iv) Me 1 gusht 2014, një pronë e mbajtur nga Molla kishte vlerë të drejtë prej €20 milion mbi vlerën e saj bartëse. Pjesa e ndërtesave të kësaj prone, që përbënte 75% të vlerës totale, kishte jetë ekonomike të përdorimit të mbetur prej 10 viteve në datën e blerjes.
- (v) Gjatë vitit financiar të përfunduar me 31 korrik 2016, Molla kishte shitur mallra tek Dardha në shumë prej €60 milion. Çmimi i blerjes përfshiu një marzhë prej 20% mbi kosto. Marzha normale e Mollës në mallrat e shitur është 60%. Nga këto mallra, një e katërta mbeti në stoqet në fund të Dardhës në datën e raportimit.
- (vi) Ishte regjistruar në librat e Dardhës një e pagueshme tregtare ndër-grupore prej €20 milion që i kishte borxh Mollës në fund të vitit. Megjithatë, librat e Mollës terguan një saldo prej €22 milion borxh nga Dardha. Kjo ndodhi për shkak se sistemi kompjuterik i Mollës automatikisht kishte ngarkuar tek llogaria e Dardhës interesin prej €2 milion për shkak të vonesës së pagesës. Me pas është arritur marrëveshja që Molla do të hiqte dorë nga ky interes.
- (vii) Dardha nuk ka kontabilizuar ndonjë dividend të arkëtueshëm ngë kompanitë e grupit të saj. Edhe Dardha edhe Qershia kanë propozuar dividenda siç është treguar në detyrimet afatshkurtëra. Nuk janë propozuar apo paguar dividenda tjera gjatë vitit.
- (viii) Zëri i mirë është rishikuar për dëmtim në datën e raportimit, dhe një humbje nga dëmtimi prej €3 milion është konsideruar e domosdoshme për zërin e mirë të Mollës. Një humbje nga dëmtimi prej €1 milion duhet të regjistrohet për investimet në Qershia.
- (ix) Të gjitha llogaritjet mund të rrumbullaksohen në €0.1m më të përafërt.

Kërkohet:

Përgadite pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare të grupit Dardha me 31 korrik 2016 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

(25 pikë)

1. Struktura e grupit:

Dardha ka në pronësi 300m aksione nga 400m në Molla. Kjo i jep 75% pronësi në Molla për dy vite të plota. Andaj Molla është një degë.

Dardha ka 40% pronësi në Qershia për tërë vitin dhe mund të caktoj drejtorët, andaj mund të ushtrohet ndikim domethënës. Andaj Qershia është një shoqëri.

Pasqyra e konsoliduar e pozitës financiare e grupit Dardha sh.a me 31 korrik 2016

	€ milion
<i>Pasuritë jo-qarkulluese: [= 100% Dardha + 100% Molla]</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (500 +145 +17 (L15))	662.0
Zëri i mirë(L11)	34.0
Investimet në Shoqëri (L14)	52.6
Investimet tjera (300 -220 -50 +48)	<u>78.0</u>
	826.6
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet (180 +51 -2.5 (L16))	228.5
Të arkëtueshmet tregtare (64 +24 -2 (L17) -20 (L17))	66.0
Dividenda e arkëtueshme nga Shoqëria (L18)	4.0
Paraja & Banka (24 +13)	<u>37.0</u>
	335.5
Total pasuritë	1,162.1
<i>Ekuiteti:</i>	
Aksionet e ekuitetit	250.0
Premia e aksioneve	200.0
Fitimet e mbajtura (L12)	<u>365.7</u>
	815.7
Interesat Jo-kontrollues (L13)	<u>64.4</u>
	880.1
<i>Detyrimet afat-gjata:</i>	
6% notë krediti	100.0
<i>Detyrimet afat-shkurtëra:</i>	
Të pagueshmet tregtare (143 +36 -20 (L17))	159.0
Interesi i pagueshëm në 6% notë krediti (L11)	6.0
Dividenda e propozuar proposed (17)	17.0
	<u>282.0</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,162.1

L11 Llogaritja e zërit të mirë në blerjen e Mollës

Konsiderata

€ milion

Notat e kreditit		100
Paraja		<u>120</u>
		220
Vlera e IJK (25% * 244)		61
VD e neto pasurive të blera		
Kapitali aksionar	100	
Premia e aksioneve	80	
Rezervat para blerjes	44	
VD – Prona (L15-shënim iv)	<u>20</u>	<u>(244)</u>
Zëri i mirë		37
Humbja nga dëmtimi (shënim (viii))		<u>(3)</u>
Saldo		34

Shënim:

(1) dëmtimi i zërit të mirë i ngarkohet në tërësi fitimeve të mbajtura të grupit pasi që është e përshtatshme për metodën e përdorur (pjesa proporcionale e pasurive neto të identifikueshme).

(2) Interesi për vitin duhet të llogaritet dhe regjistrohet (€100m * 6%):

D	Rezerva e fitimeve të mbajtura €6m
K	Detyrimet afatshkurtëra €6m

L12 Fitimet e mbajtura të grupit me 31 korrik 2016

	Dardha € milion	Molla € milion
Saldo sipas PPF	358	65
Minus saldo në blerje (shënim (i))		(44)
Interesi në kredi 6% (L11)	(6)	
Levizjet ne VD (ndërtesat) (L15)		(3)
FPR në stoqe për shitjet ndër-grupore te Dardha (L16)		(2.5)
Eliminimi i interesit ngarkuar Dardhës (L17)		(2.0)
Dividenda e arkëtueshme nga shoqëria (L18)	4.0	
Zëri i mirë i dëmtuar (L11)	<u>(3.0)</u>	<u> </u>
Rezervat e korrigjuara për konsolidim	353.0	13.5
Konsolidim Molla (75% * 13.5)	10.1	
Pjesa e fitimeve të mbajtura të shoqërisë (40% * (61-52))	3.6	
Humbja nga dëmtimi në investimin tek shoqëria	<u>(1.0)</u>	
Total grupi	365.7	

L13 Interesi jo-kontrollues me 31 korrik 2016

	Molla € milion
Saldo në blerje (vlera proporcionale nga L11)	61
Pjesa e rezervave pas blerjes L12 (25% * 13.5)	<u>3.4</u>
Total	64.4

L14 Investimet në shoqërinë Qershia

	€ milion
Saldo në blerje (vlera proporcionale nga L11)	50
Pjesa e rezervave pas blerjes 40%*(61 -52)	3.6
Humbja nga dëmtimi	<u>(1)</u>
Total	52.6

L15 Korigjimet e vlerës së drejtë (shënim (iv)):

	Në blerje rep. date	Levizjet	Në datë rap.
Prona Qershia	€20m	(€3m)**	€17m

**Levizjet = zhvlerësimi për korigjimin e komponentës së ndërtesës vetëm për 2 vite të plota që nga blerja:

€20m * 75% / 10 vite * 2 vite = €3m. Kjo i ngarkohet fitimeve të kompanisë që mban (dhe si rrjedhojë e zhvlerëson) pasurinë, në këtë rast Qershia. Andaj:

D PFP	€17.0m
D Fitimet e mbajtura – Qershia	€3.0m
K zëri i mirë (VD e neto pasurive)	€20.0m

L16 Treagtia ndër-grupore e mallrave

Fitimi i parealizuar (FPR) të mallrave të mbajtura në stoqet në fund:

(€60m * 20/120) * 1/4 (shitur nga Molla andaj afektohet PA IJK) €2.5m

Korigjimet për të zvogëluar rezervat (Molla) dhe stoqe:

D Fitimet e mbajtura (Molla)	€2.5m
K Stoqet	€2.5m

L17 Saldo ndër-grupore & interesi i ngarkuar – Dardha & Molla

Elimino interesin €2m:

D Fitimet e mbajtura (Molla)	€2.0m
K Të arkëtueshmet tregtare (Molla)	€2.0m

Pas korigjimit mësipër, të arkëtueshmet dhe të pagueshmet ndërgrupore tani barazohen në €20.0m. Andaj i anulohet këto saldo.

D Të pagueshmet tregtare	€20.0m
K Të arkëtueshmet tregtare	€20.0m

L18 Dividendat

Dividenda e propozuar nga Qershia	€10m
Shuma e pagueshme ndaj kompanisë prind (40%)	€4m

Korigjim për të treguar dividendën e arkëtueshme nga Dardha dhe rritur fitimet e mbajtura (Dardha).

D Dividendat e arkëtueshme	€4.0m
K Fitimet e mbajtura (Dardha)	€4.0m

2.

a) Informatat në vijim kanë të bëjnë me Dredhëza sh.p.k për vitin deri me 31 maj 2016.

Pasqyra e fitimit ose humbjës (ekstrakt) për vitin deri me 31 maj 2016.

	€'000
Fitimi para interesit dhe tatimit	60
Kosto e financimit	12
Tatimi	16

Pasqyra e pozitës financiare (ekstrakt) për vitin deri me 31 maj 2016.

	€'000
Ekuiteti	
Aksione të zakonshme prej €0.50 secila	100
Premia e aksioneve	85
Fitimet e mbajtura	40

Informatat shitesë

- (i) Me 1 shtator 2015, Dredhëza sh.p.k emetoi 50,000 aksione të ekuitetit për €2.00 secila. Çmimi paraqet vlerën e tregut të aksioneve të Dredhëza sh.p.k në atë datë.
- (ii) Me 1 dhjetor 2015, Dredhëza sh.p.k bëri një emetim bonus prej 15,000 aksioneve të ekuitetit ndaj aksionarve të saj me vlerë nominale. Ka shfrytëzuar preminë e aksioneve për këtë emetim.
- (iii) kompania i ka ofruar 10 drejtorëve të saj një opcion për të blerë secili 1,000 aksione të ekuitetit me një çmim prej €1.80 për aksion. Opcioni për të blerë aksionet do të mund të shfrytëzohet nga 1 qershor 2017. Aksionet e kompanisë kanë një vlerë mesatare të tregut prej €2.00 për aksion.
- (iv) Dredhëza sh.p.k ka €200,000 kredi të konvertueshme prej 10%. Kredia do të konvertohet në aksione me 1 qershor 2019. Kushtet e konvertimit janë 200 aksione për çdo €1,000 kredi të konvertueshme.
- (v) Aksionet e emetuara në (i) dhe (ii) mësipër janë kontabilizuar në mënyrë të duhur.
- (vi) Norma e tatimit në fitim prej 30% në vit aplikohet për Dredhëza sh.p.k.

Kërkohet:

- (a) Trego se si llogaritet fitimi themelor dhe i dobësuar për aksion. (5 pikë)
- (b) Shpjego rëndësinë e llogaritjes së fitimit të dobësuar për aksion. (2 pikë)
- (c) Llogarite fitimin themelor dhe të dobëduar për aksion të Dredhëza sh.p.k për vitin e përfunduar me 31 maj 2016. (8 pikë)

2.

1) Fitimi themelor për aksion llogaritet duke pjesetuar fitimin që i takon aksionarëve të zakonshëm me numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme të emetuara. Në mënyrë të ngjajshme, formula e mësipërme përdoret për të llogaritur fitimin e dobësuar për aksion. Megjithatë, numëruesi dhe emëruesi korigjohen për efektet e emetimeve të ardhshme të aksioneve. Por, vetëm ato transaksione të cilat kanë potencial të dobësimit të fitimit për aksion përfshihen në fitimet për aksion.

2) Rëndësia e llogaritjes së fitimit të dobësuar për aksion është të tregoj efektet e emetimeve të ardhshme të aksioneve të ekuitetit në fitimin themelor për aksion.

3) Llogaritja e fitimit themelor dhe të dobësuar për aksion

fitimi themelor për aksion = Fitimi pas interesit dhe tatimit / Numri mesatar i ponderuar aksioneve = €32,000* / 187,500 L11 = €0.17 për aksion

*(60,000 - 12,000 - 16,000)

Fitimi i dobësuar për aksion = Fitimi pas interesit dhe tatimit / Numri mesatar i ponderuar aksioneve

= €32,000 L12 / 188,500 L13

= €0.16 për aksion

Llogaritjet

L11 Numri mesatar i ponderuar aksioneve për fitimin themelor për aksion

Aksione të emetuara më çmim të tregut 50,000 x 9/12 37,500

Aksionet e emetuara bonus 15,000 x 12/12 15,000

Aksionet me 1 korrik 2015 {(100,000/0.5) - 50,000 - 15,000} x 12/12 135,000

Numri mesatar i ponderuar aksioneve 187,500

L12 Fitimi pas interesit dhe tatimit për fitimin e dobësuar për aksion €

Fitimi pas interesit dhe tatimit për fitimin themelor për aksion 32,000

Interesi i kursyer nga kredia e konvertueshme 10% x €200,00 x (1 - 0.3) 14,000

L13 Numri mesatar i ponderuar aksioneve për fitimin e dobësuar për aksion

Numri mesatar i ponderuar aksioneve për fitimin themelor për aksion 187,500

Aksionet nën opcionin për aksione 10 x 1,000 10,000

Aksionet nën opcionin për aksione në vlerën e drejtë 10,000 x €1.8/€2 (9,000)

188,500

Aksionet nën kredinë e konvertueshme (€200,000/€1,000) x 200 aksione 40,000

Potenciali dobësues i kredisë së konvertueshme

= €14,000/40,000 aksione = €0.35

Kjo është më e lartë se FPA-ja themelore prej €0.17. Kredia pra nuk duhet të përfshihet në FPA-në e dobësuar pasi që nuk ka efekt potencial të dobësimit.

3. Limoni sh.a është një kompani e listuar në bursë. Si një kontabilist financiar, ju janë paraqitur pasqyrat e pëmbledhura financiare në vijim të Limoni sh.a.

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 30 shtator 2016.

	€'000
Të hyrat	22,960
Kosto e shitjeve	<u>(19,360)</u>
Fitimi bruto	3,600
Të hyrat tjera – fitimet nga investimet	240
Kostot e shpërndarjes	(480)
Shpenzimet administrative (shënim ii)	(1,400)
Kostot financiare	<u>(200)</u>
Fitimi para tatimit	1,760
Tatimi	<u>(640)</u>
Fitimi për vitin	1,120
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Përfitimet nga rivlerësimi i pronës	400
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	1,520

Pasqyra e pozitës financiare me;

	30 shtator 2016 €'000	30 shtator 2015 €'000
Pasuritë		
<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>		
Prona, fabrika dhe Paisjet (shënim (i))	11,520	7,440
Investimet (shënim (i))	<u>1,680</u>	<u>1,600</u>
Total pasuritë jo-qarkulluese	13,200	9,040
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Stoqet	4,840	3,240
Të arkëtueshmet tregtare	1,920	2,160
Pasuritë e tatimit të shtyrë	-	200
Banka	<u>40</u>	<u>-</u>
Total pasuritë qarkulluese	<u>6,800</u>	<u>5,600</u>
Total pasuritë	20,000	14,640

Ekuiteti dhe detyrimet

Ekuiteti:

Aksionet e zakonshme prej 20 cent secili (shënim (iii))	4,000	2,400
Premia e aksioneve	2,400	-
Rezerva e rivlerësimit	600	200
Fitimet e mbajtura	<u>5,760</u>	<u>5,240</u>
Total fondet e aksionarve	12,760	7,840
	30 shtator 2016	30 shtator 2015
	€'000	€'000

Detyrimet afatgjata:

8% notë krediti (shënim (ii))	-	1,600
--------------------------------	---	-------

Tatimi i shtyrë	<u>200</u>	<u>120</u>
Total detyrimet afatgjata	200	1,720
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>		
Të pagueshmet tregtare	5,640	4,200
Mbitërheqja bankare	-	480
Provizionet për garancion	800	400
Taimi aktual i pagueshëm	600	-
Total detyrimet afatshkurtëra	<u>7,040</u>	<u>5,080</u>
Total Ekuiteti dhe detyrimet	20,000	14,640

Informata shtesë:

- (i) Limoni sh.a përdor vlerën e drejtë për të matur investimet e saj. Vlera e drejtë e investimeve të Limoni sh.a me 30 shtator 2016 ishte €80,000 më shumë se vlera e tyre e drejtë 12 muaj para kësaj datë. Limoni sh.a nuk ka blerë apo shitur ndonjë investim gjatë periudhës deri me 30 shtator 2016. Një zë i fabrikës që kishte vlerë bartëse prej €960,000 ishte shitur me humbje prej €360,000 gjatë vitit. Zhvlerësimi për pronën, fabrikën dhe paisjet prej €1,120,000 është ngarkuar në kostot e shitjeve për vitin e përfunduar me 30 shtator 2016.
- (ii) Notat e kreditit prej 8% janë parapaguar duke shkaktuar një ndëshkim prej €80,000 i cili është ngarkuar në kostot administrative në pasqyrën e të ardhurave.
- (iii) Limoni sh.a nuk ka bërë ndonjë emetim bonus por një emetim të aksioneve për para me 1 prill 2016.
- (iv) Limoni sh.a jep garancion prej 12 muaj për disa prej produkteve të saj që i shet. Shumat e paraqitura në detyrimet afatshkurtëra si provizion për garancion janë një vlerësim i saktë, bazuar në përvojat e kaluara, të shumave të kërkesave ndaj garancioneve që ka gjasa të bëhen në fund të çdo viti. Kostot e garancionit janë të përfshira në kostot e shitjeve.
- (v) Një dividend prej 3 cent për aksion ishte paguar në korrik 2016.

Kërkohet:

Përgadite pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme për Limoni sh.a për vitin e përfunduar me 30 shtator 2016 në pajtim me SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë. (20 pikë)

3. Limoni sh.a

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar me 30 shtator 2016

	€'000	€'000
Rrjedhat e parasë nga aktivitete operative		
Fitimi para tatimit		1,760
Shto:		
Humbjen nga shitja e fabrikes		360
Zhvlerësimi		1,120
Ndëshkimi për pagesë të mëhershme		80
Shpenzimet e interesit		200
Fitimet nga investimet		(240)
Rritja në provizionet për garancion		<u>400</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet para levizjeve në kapitalin qarkullues		3,680
Rritja në stoqe (4,840 – 3,240)		(1,600)
Zvogëlimi në të arkëtueshmet (2,160 – 1,920)		240
Rritja në të pagueshmet (5,640 – 4,200)		<u>1,440</u>
Paraja e gjeneruar nga operacionet		3,760
Interesi i paguar		(200)
Refund tatimor i pranuar (L11)		<u>240</u>
Neto paraja nga aktivitete operative		3,800
Paraja nga aktivitete investuese		
Arkëtimet nga shitja e fabrikës (L13)	600	
Blerja e fabrikës (L12)	(5,760)	
Të hyrat e arkëtuara nga investimet (240 – 80)	<u>160</u>	
Neto paraja e përdorur në aktivitete investuese		(5,000)
Rrjedhat e parasë nga aktivitetet financuese		
Aksionet e emetuara (4,000 – 2,400) + 2,400	4,000	
Notat e kreditit të paguara	(1,600)	
Ndëshkimi për pagesë të mëhershme	(80)	
Dividenda e paguar (€0.03 x (4,000,000/€0.20)	<u>(600)</u>	
Net paraja nga aktivitete financuese		<u>1,720</u>
Neto rritja në ara dhe ekuivalentët e parasë		520
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 tetor 2015		(480)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 30 shtator 2016		40

Llogaritjet

1. Llogaria e tatimit të pagueshem

€'000

€'000

Saldo në fillim: tatimi aktual	200	Saldo në fillim: tatimi i shtyrë	120
Saldo në fund: tatimi aktual	600	Fitim ose humbje	640
Tatimi i shtyrë	<u>200</u>	Refund i pranuar (shif. bal)	<u>240</u>
	1,000		1,000
		Saldo në fillim: tatimi aktual	600
		Tatimi i shtyrë	200

2. Prona, fabrika dhe paisjet llogaria

	€'000		€'000
Vlera bartëse në fillim:	7,440	Largimet	960
Teprica e rivlerësimit (600-200)	400	Zhvlerësimi	1,120
Shtesat (saldo balancuese)	<u>5,760</u>	Saldo në fund	<u>11,520</u>
	13,600		13,600

3. Arkëtimet nga shitja e fabrikës:

Vlera bartëse	960
Minus humbja nga largimi	<u>(360)</u>
Arkëtimet	600

4.

a) Në vijim është një ekstrakt nga pasqyra e pozitës financiare të Arra me 31 dhjetor 2015.

Prona, fabrika dhe paisjet

	Toka dhe ndërtesat	Fabrika dhe makineria	Paisjet kompjuterike	Total
	€	€	€	€
Kosto				
Me 31 dhjetor 2015	1,500,000	340,500	617,800	2,458,300
Zhvlerësimi i akumuluar				
Me 31 dhjetor 2015	600,000	125,900	505,800	1,231,700
Vlera bartëse				
Me 31 dhjetor 2015	900,000	214,600	112,000	1,226,600

Politikat e kontabilitetit: Zhvlerësimi

Zhvlerësimi bëhet sipas normave në vijim.

Për tokat dhe ndërtesat	2% në vit në baza drejtvizore vetëm për ndërtesat
Për fabrikën dhe paisjet	25% e saldosh të zbritur
Për kompjuterët	33.33% në vit në baza drejtvizore

Gjatë vitit 2016 ndodhën këto transaksione.

- (i) Me 31 dhjetor toka dhe ndërtesat janë rivlerësuar në €1,750,000. Nga kjo shumë, €650,000 janë për tokën (e cila fillimisht kishte kushtuar €500,000). Jeta e mbetur e përdorimit e ndërtesës është vlerësuar 40 vite.
- (ii) Një makinë e cila ka kushtuar €80,000 dhe kishte një zhvlerësim të akumuluar prej €57,000 në fillim të vitit është shitur për €25,000 në javën e parë të vitit.
- (iii) Një makinë e re është blerë me 31 mars 2016. Kosto në vijim janë shkaktuar:

	€
Çmimi i blerjes, para zbritjes, duke përfshirë TVSH-në e rimbursueshëm prej € 3,000	20,000
Zbritja	1,000
Kosto e transportit	500
Kosto e instalimit	750
Interesi në kredinë e marrë për të financiar blerjen	300

- (iv) Me 1 janar është vendosur të ndryshohet metoda e zhvlerësimit në paisjet kompjuterike nga metoda ekzistuese në 40% të saldosh të zbritur.

Kërkohet:

Përgadite një shënim të pronës, fabrikës dhe paisjeve ashtu siç do të paraqitej në pasqyrat financiare të Arra për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016. (10 pikë)

- b) Portokalli hyri në transaksionet në vijim gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2016. Drejtorët e Portokalli dëshirojnë të kapitalizojnë të gjitha pasuritë kurdo që është e mundur.

- (i) Me 1 janar Portokalli bleu neto pasuritë e Mandarina for €105,000. Neto pasuritë e blera kishin këto vlera në libra dhe të drejta.

	Vlera në libra	Vlera e drejtë
	€	€
Zëri i mirë	5,000	5,000
Patenta	15,000	20,000
Pasuritë jo-qarkulluese	40,000	50,000
Pasuri tjera neto të ndryshme	<u>30,000</u>	<u>25,000</u>
	90,000	100,000

Patenta skadon në fund të vitit 2023. Zëri i mirë që rrjedh nga mësipër kishte jetë të rikuperueshme në fund të vitit 2016 prej €7,000.

- (ii) Me 1 prill Portokalli bleu një brend (markë tregtare) nga një konkurent për €50,000. Drejtorët e Portokalli e kanë vlerësuar jetën e përdorimit të brendit në pesë vite.
- (iii) Gjatë viti Portokalli shpenzoi €40,000 në zhvillimin e një brendi (markë tregtare) të ri. Zhvillimi përfundoi me 30 qershor. Jeta e përdorimit të këtij brendi është vlerësuar tetë vite.
- (iv) Drejtorët e Portokallit besojnë që ka një zë të mirë prej €2 milion brenda Portokallit dhe i cili ka një jetë të pakufishme të përdorimit.

Kërkohet:

Përgadite një shënim në pasqyrat financiare për pasuritë e paprekshme me 31 dhjetor 2016.
(10 pikë)

4.

a) Pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 (ekstrakt)

Prona, fabrika dhe paisjet

	Toka dhe ndërtesat	Fabrika dhe makineria	Paisjet kompjuterike	Total
	€	€	€	€
Kosto/vlerësimi				
Me 1 janar 2016	1,500,000	340,500	617,800	2,458,300
Rivlerësimi	250,000	-	-	250,000
Shtesat (L12)	-	17,550	-	17,550
Largimet	-	(80,000)	-	(80,000)
Me 31 dhjetor 2016	1,750,000	278,050	617,800	2,645,850
Zhvlerësimi i akumuluar				
Me 1 janar 2016	600,000	125,900	505,800	1,231,700
Ngarkesa për vitin (L11)	20,000	51,191	44,800	115,991
Rivlerësimi	(620,000)	-	-	(620,000)
Largimet	-	(57,000)	-	(57,000)
Me 31 dhjetor 2016	-	120,091	550,600	670,691
Vlera bartëse				
Me 31 dhjetor 2015	900,000	214,600	112,000	1,226,600
Me 31 dhjetor 2016	1,750,000	157,959	67,200	1,975,159

Llogaritjet

(1) Shpenzimet e zhvlerësimit

Ndërtesat = $(1,500,000 - 500,000) \times 2\% = 20,000$.

Fabrika dhe pasisjet:

Makina e re $(17,550 \times 25\% \times 9/12)$

Fabrika ekzistues $((340,500 - 80,000) - (125,900 - 57,000)) \times 25\%$

€

3,291

47,900

51,191

Paisjet kompjuterike = $112,000 \times 40\% = €44,800$

(2) Kosto e makinës së re

Çmimi i blerjes $(20,000 - 3,000 - 1,000)$

Kosto e transportit

Kosto e Instalimit

Interesi në kreditë e marrë për të financuar blerjen

€

16,000

500

750

300

17,550

b) Pasuritë e paprekshme

Zëri i mirë	Patenta	Brendi	Total
-------------	---------	--------	-------

	€	€	€	€
Kosto				
Me 1 janar 2016	-	-	-	-
Shtesat (L11)	10,000	20,000	50,000	80,000
	-----	-----	-----	-----
Me 31 dhjetor 2016	10,000	20,000	50,000	80,000
	-----	-----	-----	-----
Amortizimi i akumuluar/ dëmtimi				
Me 1 janar 2016	-	-	-	-
Shlyer/ amortizuar gjatë viti (L11 dhe L12)	3,000	2,500	7,500	13,000
	-----	-----	-----	-----
Me 31 dhjetor 2016	3,000	2,500	7,500	13,000
	-----	-----	-----	-----
Vlera bartese				
Me 31 dhjetor 2015	-	-	-	-
	-----	-----	-----	-----
Me 31 dhjetor 2016	7,000	17,500	42,500	67,000
	-----	-----	-----	-----

Llogaritjet

(1) Zëri i mirë në blerjen e Mandarinës

	€
Kosto e blerjes	105,000
Minus vlera e drejte e neto pasurive të blera (100,000 – 5,000)	<u>(95,000)</u>
Zëri i mirë	10,000
Vlera e rikuperimit	<u>(7,000)</u>
Shlyrja për dëmtimin	3,000

(2) Amortizimi i patentës $20,000 \div 8 = €2,500$

(3) Amortizimi i brendit $50,000 \div 5 \times 9/12 = €7,500$

Shënim:SNK 38 Pasuritë e paprekshme ndalon njohjen e brendeve të gjeneruari se brendshmi (3) ose zerin e mire të gjeneruar së brendshmi (4).

5. Znj. Pjeshka, pronare e një firme të kontabilitetit në të cilin ju punoni rishtazi është kontaktuar nga një klient, Banana sh.p.k për disa çështje specifike lidhur me SNK 20 *Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Shpalosjet e Asistencës Qeveritare*. Znj Pjeshka ka kërkuar që ta ndihmoni në dhënien e këshillës këtij klienti.

Klienti ka informuar menaxheren tuaj me këto detaje;

- Banana sh.p.k ka aplikuar për një grant kapital nga qeveria lidhur me ndërtimin e një zgjerimi të zyrës në shtëpinë e kujdesit ndaj pleqve.
- Në vitin 2015, qeveria vendosi rregulla të reja për shtëpitë e kujdesit ndaj pleqve, duke lejuar që ndihma në forme granti tu jipen shtëpive të kujdesit ndaj pleqve të cilat po bënë përmirësime kapitale. Kushtet specifike të rregullave të reja theksojnë që, varësisht nga përmbushja e kriterëve dhe kushteve të caktuara, një grant prej deri në 60% të totalit të shumës së investuar mund të përfitohet.
- Me 1 shtator 2015, Banana sh.p.k nënshkroi një kontratë preliminare me departamentin përgjegjës për administrimin e grantit.
- Banana sh.p.k nuk mund të nënshkruante kontratën e plotë në atë kohë pasi që nuk kishin njerëz të mjaftueshëm të punësuar në shtëpinë e pleqve gjë që ishte një parakusht për fitimin e grantit.
- Gjatë kohës së nënshkrimit të kontratës preliminare, Banana sh.p.k ishte në proces të punësimit të stafit shtesë prej 10 vetave, që do ti mundësonte Banana sh.p.k-së të kualifikohej për grantin qeveritar.
- Me 8 janar 2016, Banana sh.p.k më në fund ka punësuar 10 staf më shumë dhe si rrjedhojë, ka përmbushur kushtet e fitimit të grantit.
- Kontrata për pranimin e grantit është nënshkruar me 14 janar 2016.
- Paratë e grantit janë pranuar me 28 janar 2016.
- Pasqyrat financiare nuk janë autorizuar për publikim deri me 20 mars 2016.
- Kosto e zgjerimit arriti shumën prej €96,000 e cila është paguar.
- Banana sh.p.k dëshiron të adoptoj qasjen e të hyrave për kontabilizimin e grantit qeveritar.
- Banana sh.p.k zhvlerëson tërë shumën e vitit në vitin e blerjes dhe aplikon 5% me metoden drejtvizore.

Kërkohet:

Znj. Pjeshka ka kërkuar nga ju të përgaditni një raport në të cilin adresoni këto çështje:

- (a) Shpjego, me arsye mbështetëse, pse granti i mësipërm duhet të përfshihet në pasqyrat financiare të Banana sh.p.k për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015. (8 pikë)**
- (b) Paraqiti hyrjet në ditar për të kontabilizuar informatat më lartë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. (6 pikë)**
- (c) Trego saldon përfundimtare në pasqyrat financiare të Banana sh.p.k për grantin qeveritar me 31 dhjetor 2015. (2 pikë)**
- (d) Shpjego trajtimin e nevojshëm në kontabilitet në rast se granti qeveritar duhet t'i ripaguhet qeverisë. (4 pikë)**

RAPORT

Për: Znj. Pjeshka

Nga: Asistenti Financiar

Re: SNK 20 Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Shpalosjet e Asistencës Qeveritare

Data: janar 2016

(a) Paragrafi 7 i SNK 20 thotë që grantet qeveritare nuk duhet të njihen deri sa të ketë siguri të arsyeshme që:

- i) Entiteti do t'i përmbush kushtet e percaktuara në grant; dhe
- ii) Granti do të pranohet.

Bazuar në informatat e dhëna nga Banana sh.p.k, ata i përmbushën kushtin për të pranuar grantin me 8 dhjetor 2015 dhe granti është nënshkruar me 13 janar 2016. Andaj, në këtë datë, pjesa i) e kushteve është plotësuar. Pjesa ii) e paragrafit 7 është përmbushur për faktin që grantet janë pranuar nga Banana sh.p.k me 28 janar 2016. Andaj që të dy kushtet e paragrafit 7 janë përmbushur deri me 28 janar 2016.

Pyetja është nëse granti mund të njihet në vitin 2015 apo 2016 për qëllim të pasqyrave financiare. SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese thotë në paragrafin 3 që ngjarjet pas periudhës raportuese janë ato ngjarje të favorshme apo të pafavorshme, që ndodhin ndërmjet përfundimit të periudhës raportuese dhe datës kur pasqyrat financiare autorizohen për publikim. Ngjarjet që japin dëshmi të kushteve që kanë ekzistuar në fund të periudhës raportuese quhen ngjarje korigjuese pas periudhës raportuese dhe paragrafi 8 i SNK 10 thotë që një entitet duhet të korigjoj shumat e njohura në pasqyrat financiare për të reflektuar ngjarjet korigjuese pas periudhës raportuese. Duke qënë që Banana sh.p.k kishte nënshkruar një kontratë preliminare në shtator 2015 lidhur me grantin, ngjarjet që ndodhën në janar 2016 janë ngjarje korigjuese pas periudhës raportuese andaj Banana sh.p.k mund të përfshijë grantin e qeverisë në pasqyrat e saj për vitin 2015.

(b) Hyrjet në ditar për të kontabilizuar transaksionin janë si në vijim:

		€	€
D	Prona, Fabrika & Paisjet – Pasuri Jo-qarkulluese – PPF	96,000	
K	Banka – Pasuri qarkulluese – PPF		96,000
D	Të arkëtueshmet tjera – Pasuri qarkulluese – PPF	57,600	
K	Grantet qeveritare – të hyrat e shtyera – Ekuitet		57,600
D	Zhvlerësimi – Shpenzim – PTGJ	4,800	
K	Zhvlerësimi i akumuluar – PPF – Pasuri Jo-qarkulluese – PPF		4,800
D	Grantet Qeveritare – të hyrat e shtyera – Ekuitet	2,880	
K	Të hyrat tjera – PTGJ		2,880

(c) Saldo përfundimtare e grantit nga qeveria për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 është si në vijim:

Grant i pranuar	57,600
-----------------	--------

minus amortizimi i grantit

(2,880)

Saldo përfundimtare

54,720

(d) Sipas paragrafit 32 të SNK 20, një grant qeveritar që bëhet i ripagueshëm duhet të kontabilizohet si ndryshim në vlerësimet kontabël sipas *SNK 8 Politikat e kontabilitetit, ndryshimet në vlerësimet në kontabilitet dhe gabimet*. Pasi që granti ishte fillimisht i pranuar lidhur me pasurinë e re, ripagesa e grantit duhet të njihet duke rritur vlerën bartëse të pasurisë ose zvogëluar saldon e të hyrave të shtyera për shumën që duhet të ripaguhet. Zhvlerësimi shtesë kumulativ që do të njihej në pasqyrën e të ardhurave deri në këtë datë duhet të njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Nëse keni ndonjë pyetje tjetër, ju lutem të mos hezitoni të më kontaktoni.

Sinqerisht i juaji,

Kontabilisti Financiar